V E N D I M
Nr.76, datë 18.1.1993

PËR KRITERET DHE MASËN E LLOGARITJES SË KONTRIBUTIT PËR SIGURIMET SHOQËRORE TË BUJKUT PRIVAT

Në mbështetje të ligjit nr.7541, datë 18.12.1991 "Për disa ndryshime në ligjin nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, si dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Bujku privat individ, në ortakëri ose i organizuar ne kolektiva bujqësore, i siguruar sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", përfiton sigurime për lejen e barrëlindjes, merr shpërblim për lindje fëmije e shpenzime varrimi, si dhe pensione pleqërie, invaliditeti e familjar.

2. Sigurimet për bujkun privat individ, në ortakëri ose të organizuar në kolektiva bujqësore janë të detyrueshme për gjithë personat e aftë për punë nga mosha 16 vjeç deri në kohën që plotësojnë moshën për pension pleqërie dhe kur nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë. Për rastet që bujku privat do të punojë edhe pas plotësimit të moshës për pension pleqërie, pagimi i kontributit për sigurimet shoqërore nuk është i detyrueshëm.

3. Bujku privat individ, në ortakëri ose i organizuar në kolektiva bujqësore është i detyruar të derdhë një kontribut vjetor në masën 15 për qind, kurse për rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë kontributi vjetor i tyre deri në fund të vitit 1995 do të derdhet në masën 9 për qind mbi pagat fikse vjetore të mëposhtme:

Në lekë

	Paga vjetore	Kontributi vjetor
Grupi I	10.800	1.620
Grupi II	12.000	1.800
Grupi III	14.400	2.160
Grupi IV	18.000	2.700

Për bujqit privatë, në ortakëri ose të organizuar në kolektiva bujqësore, së bashku me pjesëtarët e tjerë të familjes të aftë për punë, sigurimi bëhet vjetor për çdo person, sipas dëshirës, për një nga pagat e lartpërmendura, në bazë të deklaratës që lëshohet për këtë qëllim.

4. Për bujqit privatë, në ortakëri ose të organizuar në kolektiva bujqësore, së bashku me pjesëtarët e tjerë të aftë për punë të rretheve të favorizuara, përfitimet që përmenden në pikën 1 do të jenë të njëllojta me ato të bujqëve privatë të rretheve të tjera.

5. Kontributi derdhet pranë agjencive dhe degëve të bankave bujqësore të komunave në favor të buxhetit të sigurimeve shoqërore dy herë në vit si më poshtë:

- Në muajin qershor 30 për qind e kontributit vjetor.
- Në muajin nëntor 70 për qind e kontributit vjetor.

6. Sigurimet për lejen e barrëlindjes, shpërblimet e lindjes, shpenzimet e varrimit dhe pensionet paguhen pranë komunave për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore me paraqitjen e dokumenteve përkatëse dhe sipas dispozitave ligjore.

7. Diferenca në vleftë e masës së kontributit që paguajnë bujqit e rretheve të favorizuara me masën e kontributit që paguajnë bujqit e tjerë, i financohet çdo vit Institutit të Sigurimeve Shoqërore nga buxheti i shtetit, për vitin 1993 buxheti i shtetit do të financojë Institutin e Sigurimeve Shoqërore për mbulimin e kësaj diference me 90 milionë lekë.

8. Për zbatimin e këtij vendimi Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1993 i shtohen në organike 300 punonjës me një fond page prej 12 milionë lekësh.

9. Për grumbullimin e të ardhurave nga derdhja e kontributit të bujqëve privatë ngarkohen

këshillat e komunave dhe drejtoritë e sigurimeve shoqërore në rrethe. Për kontributet e paguara pas afatit të caktuar paguhet gjobë në masën 0,5 për qind për ditë të shumës së papaguar të kontributeve, duke filluar që nga dita kur pagesa duhet të ishte bërë. Gjoba vihet nga organet e sigurimeve shoqërore. Për mosderdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore këshillat e komunave kanë të drejtë t'i ndërpresin bujkut privat favorizimet që i jepen atij me vendime qeverie.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Ministria e Financës dhe e Ekonomisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrin udhëzim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi